



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

## VENDIM

Denoncimi me numër 12-3930/1 të datës 17.11.2020, me akuza për shkelje të ligjit në një procedurë për përcaktimin e statusit ligjor të një objekti të ndërtuar në mënyrë të paligjshme dhe në një procedurë për eksproprijimin e tokës së ndërtimit, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja përcaktoi se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme për arsye se personat e paraqitur nuk janë persona zyrtar në kuptimin e nenit 8 në përputhje me ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe nuk është lëndë për veprim kompetent të KSHPK-së.

Lënda me numër 12-7287/1 të datës 24.12.2021 të mbillet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e Komisionit shtetërorë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e miratimit.

## Arsyetim

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, më datë 17.11.2020, i ka dorëzuar KSHPK-së një denoncim, të cilin i është dorëzuar nga -----, për përfitim të paligjshëm të përfitimit pronësor nga procedurat e prokurimit publik për ekzaminime sistematike të punonjësve. nga drejtues të subjekteve juridike private dhe një person i punësuar në -----.

Sipas pretendimeve në denoncim, personi ----- kryen shërbime për prokurim publik të autoriteteve kontraktuese për përgatitjen e dokumentacionit tenderues për shqyrtime sistematike dhe prokurime tjera, në të cilat në marrëveshje të mëparshme me ----- hyn në profilin e ----- përmes kompjuterit të saj dhe duke përdorur certifikatën e tyre digjitale dorëzon oferta në emër të tyre që ajo vetë i përgatit për autoritetet kontraktuese. Në denoncim janë shënuar institucionet në të cilat

tenderin për shqyrtime sistematike e fiton -----, ndërsa bashkangjitur është shpallja për prokurim publik për shqyrtime sistematike të -----.

Pas shqyrtimit të rastit në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se denoncimi i dorëzuar nuk përmban pretendime apo indice për veprime të kundërligjshme apo të palejueshme të personave të zgjedhur apo të emëruar në ushtrimin e pushtetit publik dhe të detyrave zyrtare dhe se personat e denoncuar nuk janë rast për veprim kompetent të KSHPK-së, për arsye se KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka kompetencë të veprojë sipas kërkesës konkrete dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Nënkryetar  
**Katica Nikolovska**

Dorëzuar: Parashtruesi i denoncimit  
përgatiti: J:C  
miratoi: K.N, anëtar i KSHPK-së

